

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A- 174/2014

Prishtinë,
14 prill 2016

Në çështjen juridike të:

A.B.

Magjistranja Ferizaj - Shkup
Ferizaj

Pala ankuese

Kundër

M.A.

Rruga "Ratka Jevtića" 108/b
11460 Lisović – Barajevo BG
Beograd
Serbi

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Anna Bednarek dhe Beshir Islami, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/119/2011 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA14800), të datës 7 shtator 2011, pas shqyrtimit të mbajtur më 14 prill 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

Hedhet poshtë si e papranueshme ankesa e A.B. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/119/2011, të datës 7 shtator 2011, lidhur me lëndën e regjistruar në AKP me numrin KPA14800.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 4 dhjetor 2006, M.A. (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në ankesë), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku kërkon ri-posedimin e ngastrave të tokës të

regjistruara në Fletën Poseduese nr. 445 me numrat: 1 me sipërfaqe prej 0.33.96 ha, 2 me sipërfaqe prej 0.29.26 ha, 3 me sipërfaqe prej 0.09.36 ha dhe 4 me sipërfaqe prej 0.11.89 ha, që ndodhen në “Potok Nekodim” në Ferizaj, Zona Kadastrale Nekodim (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar).

2. Për të mbështetur kërkesën e tij ai ka dorëzuar në AKP Vendimin mbi Trashëgiminë të lëshuar nga Gjykata Komunale në Ferizaj më 8 korrik 1997 (lënda nr. O 77/96), sipas të cilit pala përgjegjëse në ankesë ishte trashëgimtare e pronës së kërkuar nga babai i tij i ndjerë S.A.. Shtojca ishte verifikuar pozitivisht nga AKP-ja.
3. Njoftimi i kërkesës ishte bërë më 15 gusht 2008. Prona ishte gjetur se ishte kullosë e cila nuk ishte e uzurpuar nga askush. Më vonë njoftimi i kërkesës ishte bërë edhe një herë përmes publikimit në Gazetën Njoftuese të AKP-së nr. 8 dhe në Buletinin e Zyrës së Pronës të UNHCR-it më 31 gusht 2010. Prona e kërkuar ishte gjetur se ishte tokë e kultivuar, livadh.
4. Asnjë uzurpues i pronës së kërkuar nuk ishte paraqitur në AKP; dhe as nuk kishte dorëzuar përgjigje në kërkesë.
5. Më 23 tetor 2008 Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK) ka lëshuar Vendimin nr. KPCC/D/A/25/2008. Me Vendimin nr. KPCC/RES/16/2010 të datës 24 shkurt 2010 Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës ka shfuqizuar vendimin e fundit. Më 7 shtator 2011, KKPK ka lëshuar Vendimin nr. KPCC/D/A/119/2011 dhe ka pranuar kërkesën duke urdhëruar në të njëjtën kohë që pala përgjegjëse në ankesë të ketë të drejtë ri-posedimi ndaj pronës së kërkuar.
6. Vendimi i ishte dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë më 28 shkurt 2012. Lënda ishte vendosur nën administrimin e AKP-së më 7 korrik 2012.
7. Më 8 prill 2014 A.B. (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) ka paraqitur ankesë në Agjencinë Kosovare të Pronës.

Arsyetimi ligjor:

8. Neni 12.1 i Ligjit nr. 03/L-079 që ndryshon Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 për Zgjidhjen e Kërkesave që kanë të bëjnë me Pronën e Paluajtshme Private përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale (në tekstin e mëtejme: Ligji) parasheh që: *“brenda (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit në lidhje me kërkesën, pala mund të paraqes përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës në Gjykatën Supreme të Kosovës ankesë kundër një vendimi të tillë”*.
9. Pala ankuese nuk ishte palë në procedurën para organit të shkallës së parë, KKPK-së, prandaj ai nuk ka të drejtë të paraqes ankesë në Gjykatën Supreme kundër vendimit.
10. Është e rëndësishme të theksohet këtu se neni 10.3 i Ligjit parasheh që *“personi me interes ligjor në kërkesë i cili nuk ka marrë njoftimin mbi kërkesën mund të pranohet si palë kurdoqoftë gjatë procedurës”*. Megjithatë, neni 14.1 i Ligjit thekson që *“Vendimi i Komisionit ekzekutohet pesëmbëdhjetë ditë pas datës së njoftimit të palëve për vendimin nëse në Gjykatën Supreme të Kosovës nuk parashtrohet ankesë.”*
11. Ankesa ishte paraqitur më 5 prill 2014, domethënë më shumë se 2 vite pas afatit për paraqitje të ankesës dhe pasi që AKP-ja e kishte vendosur lëndën nën administrimin e vet. Procedurat në lidhje me këtë lëndë tanimë kishin përfunduar. Prandaj, pala ankuese nuk mund të përfitoj nga neni 10.3 i cituar dhe të pranohet në procedurë pasi që ajo tanimë ishte përmbyllur para se kjo ankesë të paraqitej.

12. Pala ankuese nuk ka dhënë asnjë arsye për paraqitjen e ankesës pas afatit dhe Gjykata nuk mund të gjen asnjë arsye për vonesën. Në veçanti ai nuk e ka cekur se pse nuk ka marrë pjesë në procedurën para AKP-së dhe kur kishte kuptuar ai për vendimin. Prandaj, ankesa e tij nuk mund të pranohet.
13. Për të gjitha arsyet e lartpërmendura, Gjykata Supreme konsideron se kushtet sipas neneve 12.1 dhe 10.3 të Ligjit nuk janë përmbushur dhe ankesa duhet të hedhet poshtë si e papranueshme. Rrjedhimisht Gjykata Supreme nuk ka mundur të shqyrtoj bazën e cekur në ankesë.

Këshillë ligjore

14. Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.
15. Ky aktgjykim nuk e paragjykon të drejtën e palës ankuese për ta dërguar lëndën e tij në gjykatën kompetente jashtë juridiksionit të paraparë me dispozitat e nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079.

Sylejman Nuredini, Kryetar i trupit gjykues

Beshir Islami, Gjyqtar

Anna Bednarek, Gjyqtare e EULEX-it

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it